

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE**

**PROGRAMI I EDUKIMIT MUZIKOR**

**KLASA VI**

**Tiranë, 2005**

## **HYRJE**

Edukimi muzikor në klasën e gjashtë ka si synim aftësimin e mëtejshëm të nxënësve për të përjetuar muzikën dhe për t'u shprehur nëpërmjet saj. Të gjitha njohuritë që do të jepen në linjat e këndimit, bazave të arsimimit muzikor, dëgjimit muzikor, luajtjes në instrument, krijim/shprehje, do të ndikojnë të zhvillojnë dhe ta pajisin nxënësit me njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera.

Zhvillimi i muzikalitetit duke iu përgjigjur muzikës me një shumëllojshmëri veprimtarish muzikore, përfshijnë këngën, dëgjimin e pjesëve muzikore, veprimtaritë ritmike dhe harmonizimin e lëvizjeve ekspresive të trupit, luajtjen me instrumentin e fyellit, lëvizjeve ritmike, popullore, veprimtari të cilat përfshijnë, improvizimin dhe krijimin.

Shumë koncepte të reja muzikore jepen përmes këndimit, duke i gjetur dhe duke i zbatuar ato në praktikë, për shembull, ushtrime ritmike dhe melodike, shkallë, kanone etj. Këto njohuri që do të zhvillohen në këtë nivel, janë njohja, shkrimi dhe leximi i notave, çelsi i solit, nota  $\frac{1}{4}$  si njësi numërimi, masat 2-3-4-kohore, pushimet e tyre, pika e vlerës, toni dhe  $\frac{1}{2}$  toni, shkalla Do+ dhe la -, tempi etj.

Futja e instrumentit të fyellit në klasën e katërt e në vazhdim, është një element i ri në kurrikul, sepse përmes njohjes dhe luajtjes me këtë instrument, nxënësit do të jenë më të saktë nga ana intonative, do të kuptojnë më mirë tingujt, shkallët, akordet etj., do të krijojnë një vijë melodike në kohët e mësuara dhe do të luajnë pjesë për këtë instrument. Instrumenti, ashtu si dhe libri i nxënësit, është pjesë e paketës. Në këtë klasë nxënësi përkrah mësimin të shkrimit dhe leximit të notave, kohëve  $\frac{2}{4}$ ,  $\frac{3}{4}$ ,  $\frac{4}{4}$ , do t'i konkretizojë ato nëpërmjet fyellit, duke e finalizuar në fund të vitit me një pjesë shumë të thjeshtë.

Një veçori tjetër është se ky program nuk zhvillon vetëm aftësitë praktike dhe artistike, por u jep mundësi nxënësve të formojnë aftësitë e tyre për të arsytuar, duke menduar dhe shprehur në mënyrë kritike emocionet e tyre rreth muzikës. Ata i përjetojnë këto emocione përmes arteve të tjera, si: vizatimi, poezia etj.

Gjithashtu, ky program ka një një veçori, që është zhvillimi i procesit të humanizimit dhe socializimit të nxënësve me muzikën.

Programi synon të zhvillojë shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

Mësimi i muzikës ka për qëllim që nxënësit në fund të klasës së gjashtë:

- Të këndojnë kanone dhe këngë për fëmijë, të huaja, popullore, me një tematikë të larmishme, me vesh dhe me nota;
- Të ripërtërijnë dhe zhvillojnë shprehitë e të kënduarit;
- Të mësojnë bazat e shkrimit muzikor brenda shkallës DO +, la -;
- Të luajnë në instrumentin e fyellit;
- Të shoqërojnë këndimin me instrumente ritmike dhe ORF;
- Të dëgjojnë pjesë muzikore, vokale dhe instrumentale;
- Të përjetojnë muzikën dhe të zhvillojnë aftësitë krijuese, në lidhje me artet e tjera.

Edukimi muzikor në klasën e gjashtë synon t'i formojë nxënësit si përjetues të muzikës nëpërmjet këndimit, dëgjimit, luajtjes në instrument dhe vlerësimit.

## **LINJAT E PROGRAMIT**

1. Këndimi
2. Bazat e arsimimit muzikor
3. Luajtja në instrument
4. Dëgjim muzikor
5. Shprehje dhe krijim muzikor

### **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

#### **LINJA I. Këndimi**

**22 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të këndojnë këngë për fëmijë, të kultivuara, popullore, të huaja me një ose dy zëra;
- të përjetojnë ndjenjën ritmike dhe melodike përmes këndimit të këngëve të ndryshme;
- të dallojnë ndryshimin e ritmit në këngë të ndryshme;
- të këndojnë dhe të zbatojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
  - rregullat e frymëmarrjes,
  - qëndrimi drejt,
  - diksioni,
  - këndimi me ndjenjë,
  - frazimi i rrjedhshëm etj.;
- të këndojnë kanone vetëm dhe në grup, me dy zëra;
- të këndojnë duke respektuar tempin dhe shenjat e ngjyrimit;
- të këndojnë solo;
- të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- të këndojnë dhe të interpretojnë me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse;
- të shfaqin shijet e tyre për këngë të ndryshme (këngë për fëmijë, të huaja ose të krahinës).

Objektia socialë:

- të shprehin mendimin rreth muzikës që ata këndojnë.

#### **LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor**

**20 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- Të njohin, të dallojnë, të shkruajnë, të lexojnë dhe të respektojnë:
  - notat muzikore;
  - lartësinë e notave
  - gjatësinë e notave;
  - çelsin e solit dhe notat;
  - masën dhe shenjat e përsëritjes;
  - notat sipër dhe poshtë pentagramit;
  - nota  $\frac{1}{4}$  si njësi numërimi;
  - kohët e thjeshta, masat 2-3-4-kohore;

- pushimet e kohëve të thjeshta;
- pika e vlerës;
- të njohin T dhe  $\frac{1}{2}$  T;
- të ndërtojnë dhe të këndojnë shkallën Do+, la -, duke njohur karakteristikat e tyre;
- të krijojnë modele të thjeshta ritmike në kohët e mësuara.

### **LINJA III. Luajtja me instrument**

**8 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- Të luajnë notat muzikore në fyell;
- të luajnë gjatësitë dhe pushimet e notave;
- të luajnë ushtrime në kohët  $\frac{2}{4}$ ,  $\frac{3}{4}$ ,  $\frac{4}{4}$ ;
- të luajnë shkallën Do+;
- të luajnë shkallën la-;
- të luajnë një pjesë të thjeshtë për fyell (popullore);
- të zbatojnë tempin dhe shenjat e ngjyimit gjatë luajtjes;
- të shoqërojnë këngët apo meloditë, me vegla ritmike ose ORF.

### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

**8 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- Të dëgjojnë pjesë të ndryshme vokale, instrumentale, vokal – instrumentale;
- të dëgjojnë pjesë nga instrumentistë popullorë (fyell);
- të dallojnë disa instrumente të grupeve: idiofonë, aerofonë, kordofonë, membranofonë;
- të shpjegojnë karakterin e pjesëve të ndryshme muzikore;
- të rinjohin pjesë të ndryshme muzikore.

### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor**

**4 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të:

- Të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vizatim, poezi etj;
- të krijojnë një vijë melodike në kohën  $\frac{4}{4}$ ;
- të plotësojnë masat mbi një kohë të dhënë;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë.

Objektiva sociale:

- të listojnë disa veprimtari që zhvillohen në komunitetin e tyre ose në jetën e tyre të përditshme, si: muzika e dëgjuar në televizion, festat familjare, festat apo spektaklet në krahinë apo në vend;
- të listojnë disa fjali, shprehje që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

### **Orë në dispozicion**

**8 orë**

Këto orë do të jenë kryesisht, në shërbim të përforsimit të njohurive muzikore, përforsimit të njohurive dhe ushtrimit në instrumentin e fyellit apo edhe të ndonjë kënge të vështirë. Instrumenti i fyellit do të shoqërojë mësimin e notave duke i konkretizuar ato përmes luajtjes në fyell. Kështu, nxënësi i njeh, i shkruan, i lexon, i këndon dhe i luan ato edhe në instrument.

\* Shënim për linjën 2. Në këtë linjë mësuesi përforcon njohuritë e marra mbi ritmin dhe vetitë e tingullit, që do ti paraprijnë dhe janë bazë për shkrimin dhe leximin e muzikës.

## METODOLOGJIA

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga mësuesi, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve, të përmbajtjes së temës mësimore, të bazës didaktike që ai ka etj. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies, që gjejnë zbatim gjatë një ore mësimi, janë të larmishme. Të tilla mund të jenë: konkurse muzikore, lojëra didaktike që lidhen me zhvillimin ritmik dhe melodik, me dëgjimin, teste etj.

E rëndësishme është që mësuesit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre muzikore. Mësuesit të organizojnë veprimtari praktike sa të jetë e mundur, pasi shumë aftësi të përcaktuara në këtë program, arrihen nëpërmjet saj. Mësuesi zhvillon ato forma apo metoda, të cilat bëjnë të mundur asimilimin me lehtësi të veprimtarive të ndryshme krijuese.

Një vend shumë të rëndësishëm në organizimin e orës së mësimi ka formulimi i objektivave, si dhe përcaktimi i metodave që do të përdorë mësuesi për të qenë sa më i sukseshëm. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë ai, në përputhje me nivelin dhe përmbajtjen e temave të ndryshme mësimore, të bazës materiale mësimore që siguron në klasë.

*Edukimi i shprehive të kënduarit:* arti i këngës, në përgjithësi, dhe i këngës korale, në veçanti, është i ndërlikuar dhe kërkon zotërimin e një seri shprehish praktike dhe njohurish teorike, të cilat do t'i fitojnë nxënësit në orën e mësimi të këngës.

Kënga, e kënduar qoftë individualisht edhe në grup, kërkon një përqendrim më të madh, për arsye se në të konkurrojnë së bashku tri elemente, të cilat kanë forcë shprehëse të papërshkrueshme: 1) vija melodike, 2) teksti (poezia), 3) interpretimi. Të tria këto elemente mund të zërthehen si më poshtë:

a) Njohja e diapazonit të nxënësve ka një rëndësi të madhe për punën praktike të mësuesit në klasë dhe për edukimin e drejtë të aftësive dhe shprehive vokalo-korale.

b) Intensiteti i zërit, është një nga karakteristikat që zëri dëgjohe më fort ose më dobët, e cila varet nga amplituda (gjerësia e dridhjeve), ku mësuesi duhet të tregojë një kujdes të veçantë në zhvillimin e tij.

c) Timbri, ndihmon për të realizuar plotësisht këngën, duke respektuar dijet që kanë marrë në ciklin fillor.

d) Pozicioni gjatë të kënduarit.

e) Frymëmarrja (përdorimi i diafragmës).

f) Intonimi i saktë i këngëve.

g) Diksioni i qartë - frazimi i rrjedhshëm etj.

Këto karakteristika kërkojnë që kënga të këndohet nga nxënësit jo në mënyrë formale, por në mënyrë shprehëse. Nxënësit duhet të njihen mirë me krejt figurën poetike e muzikore të këngës që mësojnë e këndojnë. Mësuesi duhet t'u mësojë e t'u ushtrojë nxënësve mënyrën e të kënduarit shprehës, d.m.th., gjatë të kënduarit, të shprehin përmbajtjen dhe karakterin e këngës. Një interpretim i bukur, bëhet i mundshëm vetëm në bazë të shprehive vokale të përmendura më lart dhe në bazë të nxitjes dhe edukimit të nxënësve për një të kënduar të bukur.

*Edukimi i koncepteve muzikore duke i njohur dhe ekzekutuar ato.* Në klasën e gjashtë nxënësit marrin njohuri muzikore të zgjeruara, të cilat lidhen ngushtë me të

gjithë punën edukative-artistike muzikore. Mësimi i këtyre njohurive nuk përbën një qëllim në vetvete, por ato janë mjeti që do t'i ndihmojë nxënësit për të kuptuar muzikën dhe për ta përvetësuar atë sa më lehtë. Njohuritë në lidhje me notacionin muzikor (emërtimi i notave, grafiku i notave dhe i gjithë shenjave të tjera, që shërbejnë për të kuptuar muzikën e shkruar, leximi i tyre ose solfezhi siç quhet “ të lexuarit dhe të kënduarit e notave në pentagram”, përbëjnë përgatitjen muzikore të nxënësve, zhvillimin e tyre të përgjithshëm, si dhe numrin e orëve të parashikuara në planin analitik. Përsa i përket shkrimit, emërimit e këndimit të notave haset një vështirësi e madhe në praktikën pedagogjike, sepse me të drejtë, kur një fëmijë vjen në klasë të parë dhe fillon të mësojë abetaren, ai zotëron mirë gjuhën e folur, e kupton atë dhe di ta përdorë mirë atë për të shprehur ndjenjat e mendimet e tij, di gjithashtu se ajo që flitet mund të shkruhet e të lexohet, e megjithatë për mësimin fillestar të abetares parashikohen për një kohë të gjatë mësimet për çdo ditë. Krejt e kundërta ngjet në muzikë, prandaj për të krijuar pak a shumë kondita analoge me ato që ekzistojnë në punën e mësimin të gjuhës (shkrim-këndimit), nxënësit duhet të fillojnë të këndojnë këngë ende pa ditur shenjat përkatëse me të cilat rregjistrohen ato, ashtu siç flasin pa i njohur gërmat. Pasi nxënësit janë njohur me 7 notat muzikore në klasën e gjashtë, mësuesi i njeh me shkrimin e notave në pentagram dhe me çelsin e solit. Për të përvetësuar fazën në të shkruarit e notave, në çelsin e solit, mësuesi jep shembuj në klasë dhe detyra.

- Mësuesi duhet të bëjë forma të thjeshta didaktike, si: duke diktuar nota të ndryshme, për shembull mi - fa, sol etj., duke i shkruar të shtata notat muzikore.
- Ushtrimet të thjeshta me 5 – 6 – 7 nota shkruhen në dërrasë të zezë dhe mund të kopjohen nga fëmijët, ku më pas lexohen e këndohen me ndihmën e mësuesit.
- Në etapat e mëvonshme zgjerohen njohuritë e nxënësve me masën, pushimet.

Puna përgatitore për kuptimin e masës është tepër e rëndësishme, prandaj është e domosdoshme, që për të dhënë nocionet e theksit në muzikë, të zgjidhen këngë të njohura, në të cilat theksat muzikorë dhe theksat e fjalëve të përputhen.

Duhet patur parasysh që puna përsa i përket masës, bëhet pa u shpejtuar dhe caktohen për të disa mësimet që në çdo orë futet diçka e re, p.sh.: në një orë mësimi mësohen theksat e fjalëve të një kënge të mësuara, në një tjetër thuhet fjalët e këngës duke numëruar e rrahur kohën me dorë etj. Njohuritë për tempin dhe karakterin e këngëve u jepen nxënësve në ciklin fillor, duke filluar nga klasa e parë e deri e pesta, po kështu edhe në lidhje me dinamikën e shenjat e ngjyrimin. Në klasën e gjashtë nxënësit njihen me terma më të zgjeruar në lidhje me termat dinamikë dhe të ngjyrimin. Përsa i përket ritmit, mësuesi t'i kushtojë shumë kujdes orës së mësimin në lidhje me kohën  $\frac{2}{4}$ ,  $\frac{3}{4}$ ,  $\frac{4}{4}$ , me notën katërshe si njësi numërimi, notën tetëshe dhe pushimin tetësh etj., sepse ritmi lidhet ngushtë me të kuptuarit e pjesëve të ndryshme muzikore që nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë, lidhet me njohuritë e tjera muzikore, me notat, masën dhe me aftësitë për të kënduar më vonë në bazë notash.

Në klasat IV-V nxënësit marrin njohuritë e para të nevojshme për lartësinë, gjatësinë dhe mënyrën së paraqitjes së tyre grafike. Në klasën e gjashtë ata do të njihen me tonin,  $\frac{1}{2}$  tonin, shkallën do+ e la-, akordin, arpezhin. Mësuesi jep shembullin duke e kënduar shkallën do+ në ngjitje e zbritje dhe pastaj jep shembuj në tonalitetin Do+. Ushtrimet didaktike të jenë të thjeshta, melodioze, në shërbim të temës që mësojnë. Harmonizimi i ushtrimeve, këngëve me elementet e mësuara të B.A.M të shoqëruara dhe me instrumentet me goditje dhe fyell, do të rrisin aftësitë e nxënësve, duke bërë përsëritjen e njohurive të dhëna më parë me shpjegimin e temës së re me ushtrime, pra duke i përforcuar këto njohuri, si dhe duke i kontrolluar ato.

*Edukimi me instrumentin dhe loja me të.* Në edukimin muzikor të nxënësve një rol të rëndësishëm luan edhe instrumenti muzikor, fyelli. Njohja me instrumentin rrit njohuritë e tyre muzikore dhe u krijon mundësi të tjera për të hyrë në marrëdhënie më të ngushta me të. Futja e instrumentit të fyellit në procesin mësimor (përdorimi i tij edhe nga mësuesi) përmirëson këtë linjë: rrit ndjeshmërinë e nxënësve, shton interesin për muzikën, u zhvillon ndjenjën ritmike, melodike dhe harmonike, u krijon koncepte të qarta për çështje teorike praktike të muzikës. Krahas këtyre, mësuesi të ketë parasysh që nxënësit do të shoqërojnë melodi këngësh, ushtrime melodike etj.

*Edukimi për zhvillimin e shprehive gjatë dëgjimit muzikor.* Për të formuar kulturën muzikore të nxënësve kërkesa e vëmendja e mësuesit përqendrohen te vlerat artistike të pjesëve të zgjedhura për dëgjim, të cilat duhet të jenë të thjeshta. Këto pjesë muzikore duhet të plotësojnë kërkesat pedagogjike. Dëgjimi, si dhe kuptimi i një pjese instrumentale, kërkojnë një përqendrim më të matur se ndaj një kënge. Prandaj është detyrë e mësuesit që këto vështirësi t'ua lehtësojë nxënësve, duke i drejtuar për një dëgjim sa më të drejtë, duke i kthyer në dëgjues të aftë për të ndjekur muzikën e çdo lloji a gjinie qoftë ajo, si dhe duke i aftësuar ata për t'u shprehur me fjalë të thjeshta. Mësuesi gjatë dëgjimit përdor forma dhe stile pune për dallimin e pjesëve të ndryshme muzikore vokale-instrumentale, dëgjimit të këngëve në gjuhë të huaj, dëgjimi pjesëve për fyell, dëgjimin e pjesëve muzikore instrumentale ku ata bëjnë dallimin e instrumenteve me hark, frymë, goditje. Sigurisht, dëgjimi dhe konceptimi i një veprë instrumentale nuk është punë e lehtë për mësuesin dhe mund të hasë edhe në një lloj ngurimi nga ana e nxënësve, të cilët nuk shfaqin entuziazëm për këtë lloj muzike. Për të kapërcyer këto qëndrime, mësuesi i njeh nxënësit me qëllimin e orës së mësimi duke zgjedhur mirë pyetjet që duhet të bëjë. Për zhvillimin e kësaj ore, një rol të rëndësishëm të kenë edhe mjetet mësimore që mundësojnë zbatimin me sukses të dëgjimit muzikor.

*Lidhja e muzikës dhe arteve të tjera.* Nxënësit duke mësuar të kuptojnë gjuhën muzikore, do të orientohen në krijimet e tyre. Kjo punë bëhet nën udhëheqjen e mësuesit, i cili me fjalët e tij sqaron e shpjegon përmbajtjen, karakterin, strukturën, mjetet e shprehjes muzikore, cilësitë e krijimit, me të cilën janë njohur ose do të njihen. Njëkohësisht, mësuesi i njeh nxënësit me jetën dhe veprën e kompozitorit. Shprehja dhe krijimi muzikor zgjerojnë horizontin e njohurive muzikore të nxënësve dhe aftësinë e tyre për t'a kuptuar atë. Drejtimi i punës nga mësuesi dhe dëgjimi muzikor janë forma pune që zbulojnë një sërë njohurish për muzikën, improvizim ritmesh të ndryshme me pjesët që dëgjojnë, krijim mbi disa vargje dhe ritmit të dhënë, shprehje dhe përjetim me artet e tjera: vizatim, poezi, melodi etj.

Përfundimisht, dëgjimet e krijimet muzikore, të shoqëruara me shpjegimet dhe bisedat që jepen rreth tyre, në praktikë kanë rëndësi të madhe sepse ilustrohen dhe përforcohen njohuritë e muzikës. Nga ana tjetër, zhvillohen te fëmijët, elemente të emocioneve estetike, një nga shfaqjet e para të të cilave është kënaqësia që provojnë kur dëgjojnë muzikë.

#### UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë do të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi gjatë veprimtarisë praktike, d.m.th. përmes të kënduarit, të luajturit, të shprehurit dhe qëndrimit ndaj muzikës. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë. Testimi, gjithashtu, është një nga teknikat e vlerësimit që duhet të përdorë mësuesi. Testi ka rëndësi për të parë qëndrueshmërinë e dijeve të marra, si dhe nxjerrjen në pah të aftësive në të gjitha linjat.

Cilët janë komponentët që do të çonin në një vlerësim të saktë të nxënësve:

1. Kupton elementet bazë të muzikës;

2. I përdor dhe i manipulon drejt ato gjatë këndimit, lojërave, dëgjimit, komunikimit dhe vlerësimit të pjesëve;
3. Komunikon dhe shpreh mendimet e tij rreth muzikës, si dhe elementeve të saj përbërëse.

Mësuesi përveç standardeve të arritjes, mund të përdorë si udhëzues për përshkrimin e nivelit të nxënësve në përfundim të klasës së gjashtë tabelën si më poshtë vijon:



| <u>Linja 1</u><br>Këndim   | <u>Linja 2</u><br>Bazat e arsimimit muzikor   | <u>Linja 3</u><br>Luajtje në instrument             | <u>Linja 4</u><br>Dëgjim muzikor  | <u>Linja 5</u><br>Shprehje dhe krijim muzikor  |
|--|---|---|---|--|
| 1. Zhvillon shprehitë e të kënduarit, ritmin, intonacionin, diksionin.                     | 1. Shkruan dhe lexon saktë notat muzikore, si dhe notat poshtë dhe sipër pentagramit. | 1. Luan saktë notat muzikore me fyell.              | 1. Dallon karakterin në pjesë të ndryshme që dëgjon.                          | 1. Arrin të shpjegojë me fjalë të thjeshta karakterin e këngëve dhe emocionet që krijon tek ata. |
| 2. Këndon saktë këngët nga ana ritmike e melodike.   | 2. Lexon gjithmonë saktë në masat 2/4, 3/4, 4/4.                                      | 2. Luan saktë shkallën Do+ dhe la- në fyell.        | 2. Përcakton zërat e burrave, të grave, fëmijëve dhe jep disa karakteristika. | 2. Krijon modele të ndryshme ritmike.  |
| 3. Këndon kanone në grup, me një dhe dy zëra.  | 3. Njih dhe respekton pushimet në kohë të ndryshme.                                   | 3. Luan në fyell ushtrime të thjeshta 2/, 3/4, 4/4. | 3. Dallon me lehtësi nga pamja dhe tingulli instrumentet.                     | 3. Plotëson masat mbi një kohë të dhënë.   |
| 4. Këndon dhe shoqëron këngët me veglat me goditje ose ORF .                               | 4. Njih dhe këndon saktë T dhe 1/2 T.   | 4. Luan saktë një pjesë të thjeshtë muzikore.       | 4. Shpjegon me fjalë të thjeshta karakterin e pjesëve të ndryshme që dëgjon . | 4. Liston me lehtësi disa fjali për të shprehur lidhjen e tyre me muzikën.                       |
| 5. Mban qëndrim ndaj këngëve ose pjesëve muz., duke respektuar edhe mendimin e të tjerëve. | 5. Ndërton dhe këndon saktë shkallën Do+ dhe la-.                                     |   |   | 5. Përdor një fjalor të thjeshtë në përjetimin e muzikës.  |

### INTEGRIMI

Ky program nxit mundësinë për ta parë muzikën në tema të veçanta të integruar me lëndë tjera. Nxënësit do të mësojnë të zbulojnë dhe të ndërtojnë lidhjet ndërmjet muzikës dhe edukimit figurativ, edukimit fizik, letërsisë, historisë, gjeografisë, edukatës qytetare dhe të kuptojnë rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe me kulturat e tjera.

## **MJETET MËSIMORE**

Që ky programi të bëhet sa më i zbatueshëm dhe konkret si për nxënësin, ashtu edhe për mësuesin, duhet të shoqërohet me bazë materiale, mjete mësimore dhe burime të ndryshme. Libri i mësuesit dhe kaseta me materialet didaktike (këngë, lojërat muzikore, pjesë të ndryshme për dëgjim, shembuj të tingujve ose ritmeve të ndryshme), duhet të shoqërojnë këtë program.

Mjeti me përdorim vetjak është fyelli, të cilin duhet ta ketë çdo nxënës së bashku me librin. Gjithashtu, mjetet me përdorim kolektiv mund të jenë: magnetofon, fizarmonikë, kaseta, postera dhe vegla me goditje, si: shkopinj, gurë, lugë, triangolo etj.

## **VEPRIMTARITE MUZIKORE JASHTË KLASE**

Krahas punës educative-mësimore brenda në klasë, në shkollë kryhet veprimtari artistike për gjallërimin e jetës artistike, e cila do të jetë e planifikuar për mësuesin e edukimit muzikor. Kjo veprimtari artistike përfshin korin e shkollës, që mund të grupohet në korin e ciklit fillor dhe të arsimit të mesëm të ulët. Kjo veprimtari ndihmon në zhvillimin e aftësive të fëmijëve, si dhe pasuron jetën e tyre kulturore.

Klasa është burimi i këngëtarëve për korin e shkollës. Në orët e mësimit të edukatës muzikore mësuesi zbulon aftësitë e nxënësve për të kënduar duke i dëgjuar individualisht dhe duke bërë ndarjen në grup sipas zërave.

Aftësitë e nxënësit për të marrë pjesë në korin e shkollës janë:

1. Të kenë timbër fëminor.
2. Të kenë vesh muzike (intonim të saktë e ndjenjë ritmike).

Nxënësit provohen pa shoqërim instrumental. Kori i ciklit të fillor duhet të përbëhet nga nxënës të klasave III-V, sepse janë më të rritur dhe zërat e tyre janë më të tingëllueshme dhe më të stabilizuar. Numri i pjesëtarëve të korit nuk duhet të jetë më i vogël se 30 veta dhe as më shumë se 80 veta. Kori më i përshtatshëm është 60 veta, ku 35 nxënës janë zëri i parë dhe 25 nxënës janë zëri i dytë. Nxënësit vendosen në kor sipas gjatësisë së trupit dhe sipas llojit të zërit. Kori qëndron në qendër në formë harku (gjysmë rrethi).

Zëri i parë qëndron në krah të majtë të dirigjentit.

Zëri i dytë qëndron në krah të djathtë të dirigjentit.

Është mirë që kori të ketë patjetër shkallë, në mënyrë që rreshti i dytë të jetë më lart se rreshti i parë. Në pamundësi, rreshti i dytë qëndron ndërmjet hapsirave të rreshtit të parë me qëllim që nxënësit të shohin dirigjentin dhe të mos pengohet tingëllimi i zërit.

Organizimi i punës në rrethin e korit. Si rregull, puna zgjat 45 minuta, d.m.th. një orë mësimi kënge me solistët. Kurse rrethi i korit kërkon një formë organizimi më elastik dhe variant. Puna me korin ka një normë të caktuar 2 orë në javë për secilin grup, d.m.th. për korin e ciklit fillor dhe korin e klasave VI-IX, duke zbatuar 4 orët e normës mësimore në javë për veprimtari artistike. Këto orë llogariten në normën mësimore javore të mësuesit. Repertori i korit të shkollës ndryshon nga ai i programuar në klasë, sepse ka një tematikë më të larmishme, mund të kalojë mundësitë e nxënësve të zakonshëm për të kënduar, si dhe ka një kërkesë më të lartë të interpretimit të këngëve.

Si më sipër veprohet dhe me solistët e shkollës, me të cilët bëhet një punë më e kualifikuar dhe speciale. Këngëtarët e talentuar realizojnë interpretime solo, duet,

ansambël etj. Gjatë gjithë vitit mësohen 10 -12 këngë, të cilat u përgjigjen tematikave të ndryshme, festave, problemeve etj.

### **KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTEVE**

Përveç kërkesave që parashtrihen në këtë program, institucionet dhe grupet e autorëve që do të marrin përsipër hartimin e teksteve, të përqendrohen edhe në plotësimin e disa kriterëve të tjera që kanë të bëjnë si me këndvështrime të përgjithshme, ashtu edhe me këndvështrime më specifike shkencore apo didaktike, të cilat paraqiten në vijim.

#### **I. PARIME TË PËRGJITHSHME**

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë instrument i frytshëm i procesit mësimor. Për këtë arsye, tekstet e nxënësit të paraqesin veçori si në trajtimet konceptuale, ashtu edhe në formën e paraqitjes.

Hartimi i teksteve është proces. Ai duhet:

- Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe, në veçanti, me programin e reformuar dhe standardet lëndore;
- Të marrë parasysh përvojën e deritanishme të shkollës s Teksti nuk është përkthim i programit, i cili ka karakter sa detyrues aq edhe rekomandues dhe autorët duhet ta mbajnë parasysh onë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera;
- Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore, duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të nxënësve dhe mësuesve në këtë nivel;
- Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës;
- Të synojë nxitjen e ideve të reja në procesin e mësimdhënies dhe të nxënimit në lëndën e edukimit muzikor;
- Të synojë realizimin e një dokumenti me mundësi përshtatjeje, që i lë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.

## II. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË EDUKIMIT MUZIKOR

Teksti i edukimit muzikor synon të sjellë në klasë, në miniaturë, mjedisin kulturor e artistik, në të cilin jetojnë nxënësit. Ai duhet të krijojë mundësinë jo vetëm të bashkëpunimit krijues të nxënësve me njëri-tjetrin, por edhe të bashkëpunimit ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, madje më gjerë, bashkëpunimin e mjedisit brenda shkollës me jetën jashtë shkollës.

- Teksti i edukimit muzikor të jetë në përputhje të plotë me programin konkret të miratuar nga MASH. Ai të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjike që përmbahen në të. Në këtë mënyrë, teksti t'u pëmbahet qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe përmbajtjes së programit, në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysh të qëllimeve në dy nivele:
  1. Të qëllimeve të shprehura hapur në program. Kjo do të thotë që në tekst të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari që synojnë të arrihet qëllimi i shprehur në program;
  2. Qëllimeve të nënkuptuara. Kjo do të thotë që autorët e teksteve të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla, të cilat në shumë raste janë edhe themelore.
- Autorët, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe perceptimin e tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor progresi në mësimdhënien e lëndës së edukimit muzikor. Në këtë drejtim, autorët mund të shfrytëzojnë:
  - hapësirat dhe lirshmërinë e programit (orët në dispozicion ose përsëritjet),
  - aparatën pedagogjike të tekstit, i cili më shumë se çfarëdo tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.
- Teksti të japë mundësi të sjellë në klasë shembuj konkretë nga muzika shqiptare dhe e huaj.
- Nga pikëpamja pedagogjike, teksti të mundësojë realizimin e objektivave në fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve. Kjo do të thotë që teksti të mundësojë si për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit krijimin e situatave mësimore që favorizojnë realizimin e objektivave të mësipërm. Këtu të mbahet parasysh se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga veprimtaritë krijuese. Prandaj autorët e tekstit të parashikojnë ato veprimtari që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.
- Sistemi i pyetjeve në fund të njësisë mësimore (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera), të mundësojë:
  - Që nxënësit:
    - në mënyrë të pavarur të përvetësojnë informacionin e tekstit;
    - të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësisë mësimore dhe të objektivave të programit;
    - të përfshihen në veprimtari krijuese që synojnë të zhvillojnë aftësitë krijuese, artistike etj.;
    - të krijojnë mendimin dhe qëndrimet e tyre të pavarura, të mbështetura me argumente, por të pranojnë, të respektojnë dhe të marrin parasysh argumentet e të tjerëve;
  - Që mësuesit:

- të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së edukimit muzikor;
  - të planifikojnë më mirë orën mësimore;
  - të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
  - të mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
  - të mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuar gjatë procesit mësimor, të cilat janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe të shprehive të reja;
  - të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj.
- ☛ Teksti të përmbajë mësimet ose struktura mësimore të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qarta mësimore në përputhje me programin dhe me standardet lëndore.
  - ☛ Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shpesh nga burime të tjera informacioni (tekste, shembuj muzikorë didaktikë, foto të kompozitorëve, instrumenteve, evenimenteve muzikore etj.), gjë që do ta bënte tekstin ose njësinë mësimore më të pranueshme e më tërheqëse, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur individuale, kërkimore të nxënësve.
  - ☛ Gjuha e teksteve të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.
  - ☛ Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësisë mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.
  - ☛ Nga pikëpamja sasiore, autorët e teksteve të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpesh krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të dallojnë informacionin kryesor nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësisë mësimore.
  - ☛ Autorët të bëjnë kujdes që të shmangin mbingarkesën edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit në kushtet e kufizimit sasior (informacionit) dhe kohor të njësisë mësimore. Informacionet shpesh (ilustrimet, fotot, tekstet, grafikët, shembujt didaktikë, muzikorë etj.) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.
  - ☛ Njësi mësimore e tekstit të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e shërbimeve të tekstit, si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtjes së temave të veçanta.
  - ☛ Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (p.sh., temës) të jetë uniforme gjatë gjithë tekstit.
  - ☛ Faqësia e elementeve të ndarjeve mësimore (titujve, teksteve, figurave, pyetësorit, detyrave, ushtrimeve ritmike dhe melodike etj.) të jetë tërheqëse dhe e mbështetur në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe të temës, në veçanti.
  - ☛ Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, qartësimeve, ngjyrave etj. të jetë në raport të drejtë dhe në shërbim të çështjes që trajtohet.